



Primar / Dorezuar Punijeni / Prodato Received / Delivery	29.01.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Org. / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPH / HCK	388 / 2021		1 / 4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.387/2020

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.387/2020 të datës 03.12.2020 të parashtruar nga ankuesi

me adresë rruga “Afrim Zhitia” Blloku 1, Hyrja 1 nr.25, Lagjia Bregu i Diellit, Komuna e Prishtinës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 28.01.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**HEDHET POSHTË si e palejuar** ankesa me numër A.nr.387/2020 e datës 03.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.08/22 të datës 06.07.2011, në vendin e punës „Sekretar i Përgjithshëm”, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe vazhdimi të mandatit edhe për tri vite sipas Vendimit me Nr.04/194 të datës 23.07.2014 dhe Vendimit me Nr. 06/151 të datës 02.08.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pozitën „Sekretar i Përgjithshëm”, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Kryeministri i Republikës së Kosovës me datën 19.02.2020, ka nxjerre vendim me numër Nr.03/03, me cilin Sekretaret e Përgjithshëm nga ministrinë e prekura nga riorganizimi sipas Vendimit me numër Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të kalojnë në listën teprice sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil dhe të shqyrtohet mundësia e ricaktimit të tyre.

Me vendimin me numër Nr.12/15 të datës 22.07.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ankuesi \_\_\_\_\_ është ri caktuar në pozitën “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit me Nr. 06/151 të datës 02.08.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës .

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. \_\_\_\_\_ me datën 28.07.2020, ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 01-75 tek Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me të cilën ka kërkuar vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe po ashtu me të njëjtën date përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. \_\_\_\_\_ që të vihet në rend ditë për shqyrtim dhe miratim propozim- vendimi për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk ka shqyrtuar propozimin e Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën “Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ankuesi me datën 03.12.2020, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2921/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me shqyrtimin e propozimit të Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vazhdimin e mandatit në pozitën „Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit me datën 08.12.2020 e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, respektivisht tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë-Zyra e Kryeministrit, ndërsa Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, respektivisht tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë me datën 18.12.2020 ka përcjell në Këshill dokumentacionin me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2921/2020 të datës 03.12.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 19.02.2020 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Kërkesë e datës 14.04.2020; Kërkesë për ri caktim e datës 12.05.2020; Vendim i datës 22.07.2020 me numër Nr.12/15; Vendim i datës 02.08.2017 me numër Nr.06/151; Formulari për objektivat vjetore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; kërkesë e datës 28.07.2020 për vazhdim të mandatit të Sekretarit; Kërkesë e datës 28.07.2020 e Ministrit për vazhdim të mandatit të Sekretarit; Deklarata e pajtueshmërisë me Rregulloren e Punës së Qeverisë nr.09/2011 e datës 27.07.2020; Vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.08/22 i datës 06.07.2011; E-maili zyrtar i datës 28.07.2020; Njoftim i datës 05.10.2020; E-maili zyrtar i datës 03.12.2020; E-maili zyrtar i datës 10.08.2020; E-maili zyrtar i datës 07.10.2020; E-maili zyrtar i datës 01.12.2020; Kërkesa për përgjigje në ankese e datës 08.12.2020; Përgjigja në ankese e datës 18.12.2020; Vendimi me numër 3/2021 i datës 18.01.2021 i KPMSHCK-së për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A. Nr. 387/2020 të datës 03.12.2020, të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit ***është e pa lejuar sepse:***

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.08/22 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 06.07.2011, është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me mandat tre (3) vjeçar. Përmes Vendimit Nr.04/194 të datës 23.07.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesit i është vazhduar mandati për tre (3) vite, ndërsa me Vendimin Nr. 06/151 të datës 02.08.2017, ankuesit i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite tjera, deri më datë 02.08.2020, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu duke u bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.02.2020, ka nxjerr Vendimin me numër Nr.03/03 të datës 19.02.2020, për kalimin në listë rezervë të Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive të cilat janë prekur nga riorganizimi sipas Vendimit Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pjesë e listës rezervë është edhe Sekretari i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në këtë rast ankuesi

Pas Vendimit me numër Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 14.04.2020 dhe 12.05.2020 i është drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë për ri caktim/sistemim, ndërsa Kryeministri i Republikës së Kosovës, me vendim me numër Nr.12/15 të datës 22.07.2020, e ka ri caktuar ankuesin në pozitën "Sekretar i Përgjithshëm" në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit me numër Nr. 06/151 të datës 02.08.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu ka konstatuar se me datën 28.07.2020, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale z. ka parashtruar kërkesë me numër protokolli, 75 tek Kryeministri i Republikës së Kosovës, me të cilën ka kërkuar vazhdimin e mandatit të ankuesit Arben Çitaku në pozitën „Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe po ashtu me të njëjtën datë përmes e-malit zyrtar ka kërkuar nga Drejtori i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. që të vihet në rend ditë për shqyrtim dhe miratim propozim- vendimi për vazhdimin e mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk ka shqyrtuar propozimin e Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën "Sekretar i Përgjithshëm" në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ankuesi, duke marr parasysh se nuk ka pranuar përgjigje në kërkesat e tij drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 03.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 2921 të regjistruar me numër A.nr.387/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me shqyrtimin e propozimit të Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për vazhdimin e mandatit në pozitën „Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimit me numër Nr. 06/151 të datës 02.08.2017, ku shihet se ankuesit i ka përfunduar mandati me datë 02.08.2020, Vendimit me numër Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për kalimin e ankuesit në listë tepriçë, Vendimit me numër Nr.12/15 të datës 22.07.2020, me të cilin e ka ricaktuar ankuesin në pozitën „Sekretar i Përgjithshëm” në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit me numër Nr. 06/151 të datës 02.08.2017 të Qeverisë së

Republikës së Kosovës, si dhe kërkesën me numër protokolli 75 të datës 28.07.2020, të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale z. drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Drejtorit të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shqyrtimin dhe miratimin e propozim-vendimit për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 03.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.387/2020

**Ardita Perçuku-SHYTI**

*por*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së

